

Rregullat dhe zbatimi i tyre, është baza për funksionimin e çdo tregu!

Më poshtë po paraqesim rregullat për një mbarëvajtje optimale për të gjitha palët!

Subjekti / personi, që nuk i respekton ato, i hiqet automatikisht e drejta e publikimit nga 1 muaj deri në 1 vit!

**Rregulla:**

1. Publikimi, aktualizimi apo refreshi i ofertave permanent - çdo ditë në bllok – me qëllimin e vetëm për të dalë në krye, është kategorikisht me pagesë, për këdo edhe për ata që kanë vetëm **1 ofertë!!!**

2. Ndalohen:

Njoftimet që nuk i takojnë rubrikës!

Njoftimet / ofertat **dublikatë!**

Njoftimet ku mungon oferta konkrete, me karakteristikat që parashikohen në formularin publikues.

Ndalohen **Titujt** e përgjithshëm ose pa pozicion / profesion / objekt – ku mungojnë elementët që karakterizojnë ofertën dhe lodhin lexuesin / klientin!

Ndalohen elementët në tituj që kërkojnë të tërheqin vëmendjen me shprehje dhe shenja bombastike!

Abuzimi me **foto-logo**, ose vendosja e logos ne vendin ku duhet foto e objektit!

3. **Përmbajtja** e ofertës duhet të ketë elementët bazë, për të ndihmuar klientin të krijojë një vizion sa më të saktë mbi ofertën dhe ofruesin!

Për subjektet / personat privatë që publikojnë / aktualizojnë 1 herë në javë, **javën e parë**, publikimi është **falas = Free!** Përrjashtim bëjnë rubrika/at **premium**, ku kërkohet kontratë / marrëveshje paraprake!

Tabela – tarifat për të drejtën e publikimit të ofertave / njoftimeve sipas rubrikave, për 1 ofertë në Euro:

Rubrika	cmimi për 1 ofertë €/Java
vende pune	5
Jobs / Premium	20
Biznesi	10
Turizem	5
Kurse profesionale	5
Imobiliare	5
automjete	5
PC - Laptops	5
gjithë rubrikat e tjera	1

*Pyetje: Market Consulting sh.p.k, ka disa oferta në muaj, sa është tarifa?*

Në këtë rast apo edhe nëse ofertat janë në rubrika të ndryshme, është shumë më lirë dhe më fleksibël të lidhet kontratë 3 / 6 mujore apo gjithë vjetore për publikime / aktualizime **me / pa kufizim në numër (pa limite)!** Bisedoni me stafin, për të konkluduar një paketë sa më optimale dhe në bazë të nevojave konkrete.

*Pyetje: Sa kushton një njoftim në pozicion të parë të një rubrike?*

Për njoftimet e **“gozhduara”** në fillim të një rubrike, në varësi të rubrikës, cmimi fillon nga 15 Euro/java - deri 30 Euro/java (ne rubrikat e punesimit) nëse subjekti dëshiron edhe **logo në titull**, kjo kushton + 5 Euro/java

*Pyetje: Po subjektet që kanë 1 apo 2 herë në vit nevojë për publikim ofertash?*

Në këtë rast përdoret **tarifa** fikse bazë e shfrytëzimit = **30 Euro / viti**

**A ka skonto:**

Subjektet që kanë mbi 1 vit anëtarsim,

për çdo vit nga data e regjistrimit kanë **2 % ulje** nga tabela - tarifa!

Shembull:

Subjekti Market Consulting sh.p.k, është regjistruar para 5 vjetësh => 5 vjet \* 2 % = 10 % ulje!